



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 83
Prishtinë, më 18 tetor 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 18 DHE 19 TETOR 2012**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetari i Kuvendit, ndërsa i ndihmuan **Xhavit HALITI dhe Enis KERVAN**, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Në fillim të mbledhjes, kryetari i njoftoi deputetët se sot në mëngjes Policia ka hyrë në hapësirat e Kuvendit pa e njoftuar kryetarin e Kuvendit. Kryetari kërkoi nga Kabineti qeveritar, kryeministri dhe ministri që ta respektojnë ndarjen e pushteteve për ta mbrojtur demokracinë, lirinë dhe dinjitetin e institucioneve të Kosovës.

Kryetari kërkoi që nga Kuvendi të largohen forcat policore dhe dha pauzë njëorëshe.

Pas pauzës, Kuvendi i vazhdoi punimet sipas rendit të ditës.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Rexhep Selimi, Hashim Deshishku, Goran Marinković, Idriz Vehapi, Armend Zemaj, Liburn Aliu dhe Halit Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi në lidhje me atë se cili është rezultati i prekshëm që ka dalë nga vizita e delegacionit të Kosovës, gjatë kohës që i zhvilloi punimet Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, duke pasur parasysh koston e këtij udhëtimi, që arrin shumën 100 mijë euro.

Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm.

Deputetja Hykmete Bajrami parashtoi pyetje për ministrin e Financave, Bedri Hamza, në lidhje me mundësinë e rritjes së pagave për mësimdhënësit, sipas premtimit të kryeministrit, dhënë kohë më parë, se gjatë këtij mandati do të ketë rritje së paku për 50%.

Ministri Bedri Hamza iu përgjigj pyetjes së deputetes Hykmete Bajrami.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit,
10. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2011.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 3, 4 dhe 11 tetor 2012.

Deputeti Halit Krasniqi pati vërejtje në transkript rreth një lëshimi teknik në evidencimin e diskutimit të tij.

4. Shqyrtimi i Propozim-rezolutës për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë

Kryetari në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës tha se grupet parlamentare: PDK, AAK, KKR, SLS dhe Grupi “6+” kanë parashtruar në Kuvend Propozim-rezolutën për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 15 tetor 2012, Propozim-rezolutën e lartshënuar e ka radhitur në rend të ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, kërkoi që procedimi i kësaj pike të rendit të ditës të bëhet sipas Rregullores së Kuvendit.

Kryetari Jakup Krasniqi tha se në mbledhjen e fundit të Kryesisë së Kuvendit kam tërhequr vërejtjen për afatet kohore të procedimit të Propozim-rezolutës, mirëpo shumica e grupeve parlamentare kanë pranuar që kjo pikë të shqyrtohet në mbledhjen e sotme plenare.

Më pas, ia dhe fjalën propozuesit të Propozim-rezolutës, kryetarit të GP të PDK-së, Adem Grabovci.

Adem Grabovci tha se Propozim-rezolutën, në emër të grupeve parlamentare PDK, AAK, KKR, SLS dhe Grupi “6+”, e kam paraqitur në mbledhjen e Kryesisë më 15 tetor 2012 dhe jemi pajtuar që ajo të procedohet në mbledhjen e sotme plenare.

Ai në vazhdim e arsyetoi dhe e paraqiti para deputetëve Propozim-rezolutën për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Më tej, ai konstatoi se integrimi në BE është synim i përbashkët i vendeve të rajonit dhe në këtë aspekt edhe normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve tona mbetet qenësor, në radhë të parë për rajonin, por edhe më gjerë.

Pavarësia e Kosovës është çështje e pakthyeshme dhe se Serbia herët a vonë do ta pranojë shtetin e Kosovës, konstatoi deputeti Grabovci.

Në fund të fjalës së tij, ai paraqiti para Kuvendit tekstin e Propozim-rezolutës për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë atë.

Diskutimi i plotë i deputetit Adem Grabovci është dhënë në transkript

Kryesuesi Xhavit Haliti e hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Blerim Shala, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Petar Miletqi, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Myfara Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe: Arsim Bajrami, Sabri Hamiti, Alma Lama, Kymete Bajraktari, Emin Gërbeshi, Rada Trajković, Hydajet Hyseni, Rexhep Selimi, Emilija Rexhepi, Fatmir Limaj, Sadri Ferati, Agim Kuleta, Visar Ymeri, Muhamet Mustafa, Albin Kurti, Goran Marinković, Sali Asllanaj, Albana Gashi, Liburn Aliu dhe kryeministri Hashim Thaçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi i ftoi kryetarët e grupeve parlamentare që ta harmonizojnë tekstin e Propozim-rezolutës.

Më pas, tekstin e harmonizuar të Propozim-rezolutës e paraqiti Adem Grabovci.

Gjatë paraqitjes së tekstit të harmonizuar të Propozim-rezolutës nga deputeti Adem Grabovci, para foltores së Kuvendit, deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri dhe Liburn Aliu, e mbanin një pano me tekstin: “Rezoluta e nënshtrimit ndaj Serbisë”.

Më pas, kryesuesi hodhi në votim tekstin e Propozim-rezolutës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 68,
Kundër ----- 4,
Abstenime ----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, vendosi:

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të neneve 6. 1 dhe 52.2 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës.

Duke e respektuar dhe kujtuar gjithmonë të kaluarën e hidhur dhe luftën e përgjakshme të popullit tonë për liri e pavarësi,

Të përkushtuar për të ndërtuar një të ardhme në paqe dhe harmoni me fqinjët tanë,

Të vendosur për të punuar bashkërisht në integrimin e shpejtë të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në NATO,

Duke insistuar në implementimin e marrëveshjeve të arritura,

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare, të mbajtur më 18 tetor 2012, me propozimin e grupeve parlamentare: PDK, AAK, KKR, SLS dhe Grupi “6+”, miraton këtë:

R E Z O L U T Ë

Për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet procesin e zgjidhjes së problemeve ndërmjet dy shteteve të pavarura dhe sovranë, Kosovës dhe Serbisë, në interes të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet tyre, përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe avancimit të agjendës evropiane për të dy shtetet dhe për rajonin.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës rikonfirmon parimin që ky proces ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë të lehtësohet nga BE-ja dhe të mbështetet fuqishëm nga SHBA-të.

3. Dialogu dhe rezultatet e tij duhet të jenë në pajtim me sovranitetin e Kosovës, subjektivitetin ndërkombëtar, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm-
rendin unik kushtetues të Kosovës.
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës e autorizon Qeverinë e Republikës së Kosovës që ta udhëheqë këtë proces, me pjesëmarrjen e komisioneve të nevojshme të Kuvendit të Kosovës.
5. Qeveria e Republikës së Kosovës është e obliguar që t'i raportojë rregullisht Kuvendit të Kosovës për procesin e normalizimit të relacioneve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.
6. Marrëveshjet e procesit të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve do të ratifikohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Pas miratimit të Rezolutës, kryesuesi dha pauzë deri në orën 16:30.

Pas pauzës, mbledhjen e drejtoi Jakup Krasniqi.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv.

Ministri Bedri Hamza tha se Republika e Kosovës është anëtarësuar në FMN në vitin 2009 në bazë të ligjit nr. 03/L-152.

Në vazhdim, ai theksoi se ky projektligj ka për qëllim ta ratifikojë amendamentin e neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv, të miratuar nga Bordi Guvernatorëve, më 15 dhjetor 2010, me Rezolutën nr. 66-2.

Për zbatimin e këtij ligji është përgjegjëse Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Në fund, ministri Hamza i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, lidhur me shqyrtimin e këtij Projektligji, e paraqiti deputetja Safete Hadërgjonaj.

Në vazhdim për fjalë u paraqit deputeti Adem Grabovci.

Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoi që mbledhja e sotme plenare të ndërpritet dhe ajo t'i vazhdojë punimet më 19 tetor 2012.

Grupit Parlamentar i PDK-së më pas e lëshoi sallën.

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes plenare për ditën e sotme dhe konstatoi se vazhdimi i saj do të bëhet më 19 tetor 2012, në orën 10:00.

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 17:20 minuta.

* * *

E premte, më 19 tetor 2012, vazhdimi i mbledhjes plenare

Mbledhjen e kryesoi nënkryetari i Kuvendit, **Xhavit HALITI**.

Kryesuesi procedoi me pikat e mbetura të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv

Kryesuesi tha se në mbledhjen plenare të 18 tetor 2012, për këtë pikë të rendit të ditës, në cilësinë e propozuesit të çështjes, ekspozenë për projektligjin e ka paraqitur ministri Bedri Hamza, ndërsa në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, raportin me rekomandime e ka paraqitur deputetja Safete Hadërgjonaj.

Kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar për reformën e Bordit Ekzekutiv.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Hasime Krasniqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hykmete Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Fetoshi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 62 deputetë dhe se nuk ka kuorum për të vazhduar procedimin me votim të kësaj pike të rendit të ditës, pasi që për ratifikimin e këtij projektligji nevojiten 80 vota “për” të deputetëve.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Ministri Bedri Hamza tha se ky projektligj ka për qëllim të rregullojë autorizimin për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar, të propozuar nga Bordi i Guvernatorëve, më 15 dhjetor 2010.

Në vazhdim tha se kuota e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar do të rritet nga 59 milionë të drejta speciale të tërheqjes (DST) në 82,6 milionë.

Më pas, ministri Hamza u fokusua në aspekte të tjera të projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hykmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Fetoshi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Visar Ymeri dhe Hashim Dëshishku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 76 deputetë dhe se nuk ka kuorum për të vazhduar procedimin me votim të kësaj pike të rendit të ditës, pasi për ratifikimin e këtij projektligji nevojiten 80 vota “për” të deputetëve.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për punimet nga metalet e çmuara.

Ministrja Mimoza Kusari-Lila tha se ky projektligj i përcakton kushtet, mënyrën dhe veprimin e kontrollit të produkteve të punuara nga metalet e çmuara, kërkesat teknike me të cilat definohet shkalla e pastërtisë, përbërja dhe përmbajtja e metaleve tjera, metaleve jo të çmuara dhe jometaleve.

Në vazhdim ajo u fokusua në përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për punimet nga metalet e çmuara.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për punimet nga metalet e çmuara.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti - në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Sala Berisha-Shala - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Teuta Sahatqija - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Xhevdet Neziraj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Sevdije Lama - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Rasim Demiri - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Haki Demolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për punimet nga metalet e çmuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 62,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për punimet nga metalet e çmuara.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision FunkSIONAL dhe Raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion e paraqiti anëtari i këtij komisioni, deputeti Haki Demolli, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi edhe deputeti Nait Hasani, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr. 1 dhe nr 2.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 63,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi ligjin 04/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 04/L-082.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit

Kryesuesi Xhavit Haliti i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit funksional për Zhvillimit Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e paraqiti kryetari i këtij komisioni, deputeti Zenun Pajaziti, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Në lidhje me amendamentin 54, të propozuar në Raportin e Komisionit FunkSIONAL, diskutuan deputetët Hashim Deshishku dhe Biserka Kostiq, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61 dhe amendamentin nr. 62.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 69,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit.

10. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2011

Deputeti Haki Demolli, në emër të Komisionit për Legjislacion, tha se si komision e kemi shqyrtuar Raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2011 dhe kemi rekomanduar shqyrtimin në mbledhje plenare, me vërejtjet e theksuara në raportin e Komisionit Funksional.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Behar Selimi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Haki Demolli - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ahmet Isufi - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Jeton Svirca - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Jasmina Zhivković - në emër të Grupit Parlamentar SLS, Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Halit Krasniqi dhe Arsim Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2011, me vërejtjet e theksuara në raportin e Komisionit Funksional.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 47,
Kundër ----- 10,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2011, me vërejtjet e paraqitura në raportin e Komisionit Funksional.

Kryetari më pas theksoi se procedimi me votim i pikave 5 dhe 6 të rendit të ditës së mbledhjes së sotme plenare do të bëhet në mbledhjen plenare të radhës.

Kryetari në fund të punimeve të kësaj mbledhjeje konstatoi se e tërheq fjalën e tij për ministrat.

Kryetari i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes plenare në orën 11:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale